

VENDIM
Nr. 633, datë 27.10.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 822, DATË
7.10.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
DHE PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA
PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT
KONCESIONI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit, 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullave dhe të procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese, të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, të miratuar me vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të rregullores:

- a) termi “aplikim” zëvendësohet me termin “kërkesë”;
- b) termi “aplikues” zëvendësohet me termin “kërkues”.

2. Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) shkronja “ë” shfuqizohet;
- b) shkronja “g” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) Për kërkesën e projekteve deri në 20 mw, kërkuesi duhet të paraqesë një ose më shumë dokumente bankare në emër të subjektit kërkues që, të marra së bashku, vërtetojnë se subjekti disponon 20% të vlerës së investimit të përgjithshëm të propozuar. Data e lëshimit të tyre (dokumente bankare) duhet të jetë jo më parë se 5 ditë nga dorëzimi i kërkesës. Për kërkesën e projekteve mbi 20 mw subjekti kërkues paraqet dëshmi financiare të besueshme për mbulimin e financimit të projektit, të tilla si: dokumente bankare, bilance të shoqërisë, premtim financimi, garanci për mbështetje financiare nga shoqëria mëmë apo ortakët e shoqërisë, sigurim të kërkesës së lëshuar nga një agjenci sigurimi, në masën 2% të vlerës së investimit etj.”.

3. Në fund të nenit 31 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet, ky vendim zbatohet vetëm për subjektet që janë pajisur me ‘Miratim paraprak të ndërtimit të kapaciteteve të reja të energjisë’, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 61/2020, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar’.”.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama